



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGIJË

Bordi

VENDIM

Nr. 18, Datë 10.01.2018

MBI

MIRATIMIN E “RREGULLORES SË PROCEDURAVE TË PARAQITJES SË PLANIT TË INVESTIMEVE NGA OPERATORËT E TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”

Në mbështetje të nenit 16 pika 12; nenit 46 pika 12 dhe nenit 56 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” si dhe nenit 26 të “Rregullores së Organizimit, Funkzionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.01.2018, mbasi shqyrtoi draftin dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike në lidhje me miratimin e “Rregullores për procedurat e paraqitjes së Planit të Investimeve nga Operatorët e Transmetimit dhe të Shpërndarjes së Gazit Natyror”,

Konstatoi se:

- Me vendimin nr. 200, datë 24.11.2017, Bordi i ERE filloi procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e draft-rregullores së procedurave të paraqitjes së planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.
- Me shkresën nr. 100/59 Prot., datë 30.11.2017, ERE publikoi në media njoftimin për fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të investimit të operatorëve të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror.”
- Me shkresën nr. 775 Prot., datë 06.12.2017, ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe shoqëria Albgaz sh.a.
- Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët, nuk rezultoi të jenë shprehur komente apo sugjerime.
- Në vijim, pas plotësimit të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët, shoqëria Albgaz sh.a me shkresën nr. 174 Prot., datë 29.12.2017, (protokolluar në ERE me nr. 775/1, datë 03.01.2018), ka përcjellë në ERE komente mbi Rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të investimit të operatorëve të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”, të cilat u morën në kondideratë dhe u reflektuan në rregullore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë *“Rregulloren e procedurave të paraqitjes së planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”*. (Bashkëlidhur Rregullorja)
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI